

INTERVISTË ME PROF.DR. ENVER HASANIN, PROFESOR NË DEPARTAMENTIN E SHKENCAVE POLITIKE TË UP-së

# Ngecjet e proceseve shqiptare nxisin të pakënaqurit

*Enver Hasani: Mendoj se Marrëveshja Kornizë është duke ecur me mjaft vështirësi, por duke u normalizuar në kuptimin e zbatimit të saj. Tani ka mbetur edhe çështja shumë e ndjeshme e decentralizimit, nga e cila shqiptarët do të prfutoin mjaft, por edhe çështje të tjera të barazisë në organet dhe strukturat e pushtetit, që kjo duket se po implementohet jo ashtu siç edhe kanë pritur shqiptarët*

Intervistoi: Arben VESELAJ dhe Fadil MIFTARI, Prishtinë

Pesimizmin e tij duket se e ndanë vetëm një vijë e hollë nga realiteti shqiptar në Ballkan, përkitazi me të ardhmën e tij. Për optimistët, deklaratat e z. Hasani, do të dukeshin paradoks, por zhvillimet që kanë ndodhur, të paktën në Kosovë, i përgjigjen krejtësisht parashikimeve të tij. Ai është profesor i së drejtës ndërkombëtare në Universitetin e Prishtinës, ndërsa diplomoi në këtë fushë në Universitetin Bilkent të Ankarasë (Turqi), një universitet ndërkombëtar, ku ka kryer edhe magjistraturën e dytë. Zoti Enver Hasani është një ndër akademikët e rrallë shqiptarë që ka botuar dhe që boton në botën e jashtme akademike, si në revistën "Perceptions" ose "The Fletcher Forum of World Affairs". Ai është autor i një libri në anglisht, i cila është botuar në Vjenë, në shkurt të këtij vit, nga Instituti i Vjenës për Paqe dhe Menaxhim të Konfliktit.

Në këtë intervistë, Enver Hasani flet për zhvillimet dhe ngecjet e proceseve shqiptare në Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë (IRJM), por edhe për refleksionet në rast të riciklimit të dhunës atje.

**Fakti: Z. Hasani, kohëve të fundit ka pasur luhata të gjendjes së qetë IRJM, pas Marrëveshjes së Ohrit, ndërsa a mund të na thoni se kah po shkojnë proceset e filluara atje?**

**Enver Hasani:** Mendoj se Marrëveshja Kornizë është duke ecur me mjaft vështirësi, por duke u normalizuar në kuptimin e zbatimit të saj.

*Çështja e bashkimit nacional, në raportin e sotëm ndërkombëtar, çfarë është, është një çështje e cila kërkon projektim marramendës të forcës, të cilën unë nuk besoj se shqiptarët e kanë. Në historinë 100-vjeçare të shqiptarëve, ata nuk kanë pasur të projektuar ndonjë projekt të madh deri në vitin 1997. Atë projektim marramendës, kolosal e kanë kushëzuar faktori i jashtëm dhe faktori Milosheviq. Ata faktorë më nuk ekzistojnë, prandaj është fare e palogjikshme që të vij deri te mundësia e akumulimit të forcës, që do të mund të llogaritet si parakusht për bashkim nacional.*

Tani ka mbetur edhe çështja shumë e ndjeshme e decentralizimit, nga e cila shqiptarët do të prfutoin mjaft, por edhe çështje të tjera të barazisë në organet dhe strukturat e pushtetit, që kjo duket se po implementohet jo ashtu siç edhe kanë pritur shqiptarët. Çështjet atje kërkojnë kohë dhe durim, por unë mendoj se është në interesin nacional të shqiptarëve që Marrëveshja e Ohrit sa do që të vonohet, procesi politik që është nisur nga ajo të mbetet i tillë, sepse nëse fillon të shkojë në ndonjë kahje tjetër mund të jetë shumë në disfavor të shqiptarëve. Mendoj, gjithashtu se, sado që dikush mund të dëshirojë, projektim të dhunës në Maqedoni, në një shkallë çfarë e kemi parë në disa vite e fundit, ajo i takon historisë, sikurse i takon edhe pjesëve të tjera të Ballkanit, ku ishin të përfshira në konflikte. Pra, cikli i dhunës tani më është mbyllur dhe tani ne mund të shohim vetëm



• Prof. Dr. Enver Hasani

dridhje të akteve të dhunës së atyktushme, por në esencë nuk prishin trendin kryesor të keqësimit të situatës. Këto akte të dhunës vetëm sa japin shenjë dhe sinjal alarmant për të gjithë ata që duhet ta zbatojnë Marrëveshjen e Ohrit, se një gjë e tillë duhet të ndodhë dhe se alternativë e moszbatimit është dhuna dhe anarkia.

**Fakti: Pas demilitarizimit të UÇK-së (Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare), një pjesë e strukturave të saj u fut në bashkqeverisje, pas zgjedhjeve me subjektet e tjera maqedonase, mirpo duket se një pjesë jo e vogël që ishin në gjirin e UÇK-së, nuk është duke u pajtur me gjendjen aktuale. Si do të reflektohen veprimet e tyre nga një herë edhe violente karshi proceseve të nisura?**

**Enver Hasani:** Mendoj se çështja e këtyre, t'i quaj: të pakënaqurive, me situatën atje, ka manifestuar dhe po manifeston shenja violente të sjelljes. Kjo i dedikohet dy faktorëve, në rend të parë precepionit të tyre, se nuk është realizuar qëllimi i tyre politik për të cilën ata patën rrokur armët; dhe në rend të dytë, që është shumë me rëndësi të thuhet, ka qenë gabim strategjik i atyre që kanë bërë planet e reintegrimit të ish-guerilës shqiptare në Maqedoni. Unë mendoj se po të ishte bërë një plan më gjithëpërfshirës i reintegrimit në jetën civile të guerilës shqiptare, shumë probleme që sot po manifestohet, do të kishin pasur një kahje tjetër dhe, sigurisht, se nuk do të ishin shfaqur në këtë formë, pra këta janë faktorët kryesor.

**Fakti: Ju that se veprimtaria e tyre vjen si rezultat i lënies pasdore të një pjesë të ish-UÇK-së, por ata vazhdojnë të deklarohen se qëllimi i tyre është bashkimi i të gjitha trojave shqiptare, pra veprimet e tyre nuk janë të fokusuara vetëm në territorin IRJM-së?**

**Enver Hasani:** Prap e ripërsëris, se, po të kishte qenë një program më serioz më gjithëpërfshirës, sigurisht që numri i atyre që janë opozitë e armatosur, në botën shqiptare do të kishte qenë shumë më i vogël dhe në pikpamje të racionalizimit politik shumë më i arsyeshëm se sa që është sot në diskursin publik. Pra, e ripërsëris, se faktori primar është faktori i përcjepcionit të tyre, se qëllimi politik i tyre nuk është realizuar.

**Shqiptarët gjithnjë e më tepër po shihen si faktor jostabilizues në Ballkan**

**Fakti: AKSH-ja (Armata Kombëtare Shqiptare) ka marr përsipër disa raste incidentesh që kanë ndodhur jo vetëm në Maqedoni por edhe në Kosovë dhe në Luginën e Preshevës. Cili mund të jetë refleksi i këtyre veprimeve në proceset mbarshqiptare në Ballkan?**

**Enver Hasani:** Veprimet e AKSH-së mund të shikohen nga spektri i brendshëm i dinamikës së botës shqiptare në Ballkan. Në këtë "botë" paraqitja e faktorit AKSH ka shërbyer dhe shërben jo rrallë për konjuktura politike momentale dhe qërimin hespesh në skenën politike shqiptare. Në raportin kundrejt Serbisë, ky faktor jep një pretekst dhe i ka dhënë një armë mjaft të fortë Serbisë për të fituar poena sepse kufizohet me viktimizimin e saj. Sepse çdo vrasje e serbëve duket paradoks por e shpejton kthimin e Serbisë në

Kosovë dhe në raport me Këshillin e Sigurimit AKSH shihet si një faktor destabilizues, pra shqiptarët me këtë faktor në KS shihen si jostabilizues në Ballkan.

**Fakti: Këto veprime, mendoni se vijnë si rezultat i naivitetit të njerëzve apo egziston ndonjë organizim i dirigjuar nga dikush?**

**Enver Hasani:** Nuk mendoj se është çështje e naivitetit, e përsëris se është çështje e perceptonit të një grupi njerëzish që do të ekzistonin edhe nëse Kosova do të ishte shtet i pavarur ose e bashkuar me Shqipërinë. Mendoj se pas gjithë asaj lufte që ka ndodhur në këto treva ekziston edhe ajo pjesa e njerëzve të pakënaqur që do të kërkonin edhe më shumë, sepse është në natyrën e njeriut që të kërkojë të përkryerën. Është e qartë se edhe në Kosovë, një pjesë e madhe e njerëzve besojnë se çështja e Kosovës nuk është zgjidhur (ashtu edhe siç është në realitet) dhe mendoj se moszgjidhja e statusit të Kosovës, siç duhet, është katalizator kryesor dhe ushqimi kryesor i veprimeve violente në të ardhmën nga AKSH.

**Fakti: AKSH-ja thotë se lufton për bashkimin kombëtar, sa larg apo afër realitetit është kjo?**

**Enver Hasani:** Çështja e bashkimit nacional, në raportin e sotëm ndërkombëtar, çfarë është, është një çështje e cila kërkon projektim marramendës të forcës, të cilën unë nuk besoj se shqiptarët e kanë. Në historinë 100-vjeçare të shqiptarëve, ata nuk kanë pasur të projektuar ndonjë projekt të madh deri në vitin 1997. Atë projektim marramendës, kolosal e kanë kushëzuar faktori i jashtëm dhe faktori Milosheviq. Ata faktorë më nuk ekzistojnë, prandaj është fare e palogjikshme që të vij deri te mundësia e akumulimit të forcës, që do të mund të llogaritet si parakusht për bashkim nacional.

**Fakti: Një mobilizim i akademive shtetërore, të Shqipërisë dhe Kosovës, a do të mund të hartonin ndonjë projekt për bashkim kombëtar?**

**Enver Hasani:** Kjo mund të jetë vetëm një paradoks, sepse mënyra e vetme është që shqiptarët, duhet ta kuptojnë kohën dhe trendin e kohës, ambientin ndërkombëtar që na rrethon.

**(... dhe tani mendoni se ky trend nuk është në favorin e shqiptarëve?)**

**Enver Hasani:** Momentalisht ky trend është kundër nesh, sa i përket metodologjisë dhe ndërkohë që, brenda të kuptuarit aktual jep mundësi shumë më të madhe se sa këto që po i bëjmë ne, këtyre 10 apo 12 viteve të fundit, përfshirë edhe luftërat që i kemi bërë. Mendoj se me një projektim të tillë, çfarë e kemi bërë ne, të arriturat tona s'kanë mundur të jenë më shumë se kaq.

**Përqarjet shqiptare në IRJM kanë origjinën nga Kosova**

**Fakti: Cili mendoni se ka qenë roli i Kosovës karshi zhvillimeve në IRJM dhe cili është sot?**

**Enver Hasani:** Mendoj se roli i Kosovës në zhvillimet në IRJM ka qenë roli të cilën e ka luajtur shteti shqiptar (Shqipëria) në zhvillimet në Kosovë. Dhe as një përqarje e faktorit shqiptar në IRJM, duke filluar nga lëvizjet e para e deri te Marrëveshja e Ohrit, nuk mund të shpjgohet pa analizimin e raporteve të njerëzve të caktuar të Kosovës. Dhe kjo është shumë normale, sepse procese të ngjashme kanë ndodhur edhe tek popujt që kanë qenë të ndarë.

**Fakti: Ju jeni profesor i së drejtës ndërkombëtare, nga këndvështrimi tuaj, cila është prespektiva e Universitetit të Tetovës?**

**Enver Hasani:** E ardhmja e Universitetit të Tetovës ka marrë rrugën e mbarë, edhe kjo i dedikohet Marrëveshjes së Ohrit, konjukturave politike dhe gjithë asaj lufte, në fakt që është bërë për barazi të shqiptarëve atje. Mendoj se në UT ka

shumë çka për të bërë. Ndoshta duhet ndryshime nga themeli i filozofisë së punës, apo edhe nga menagjimi e deri te mënyra se si bartet dija. Është shumë shpresdhënës fakti se roli dhe misioni historik që e ka pasur ky universitet, më në fund është duke u legjitimuar dhe duke u pranuar botërisht. Ky është një hap që duhet të na gëzojë të gjithë shqiptarëve. UT-ja besoj se është duke ndryshuar sepse po hyn në një botë konkurente, e cila është e pamëshirshme, botë e cila nëse don të ekzistosh të duhet të përshtatesh.

**Fakti: Ju that se UT-ja është në rrugë të mbarë, mirpo duket se strukturat udhëheqëse të tij, kanë trashëguar përqarjet që ndodhin edhe në Universitetin e Prishtinës. A ndikojnë këto përqarje ne proceset avnancuse për UT-në?**

**Enver Hasani:** Mendoj se po, dhe më lejoni të them po të shikohet origjina e atyre përqarjeve, jo vetëm në UT por në krejt botën intelektuale shqiptare në IRJM, ka origjinën nga Kosova.

**(...pse e mendoni kështu?)**

**Enver Hasani:** Sepse problemet e Kosovës, duke filluar prej problemeve personale dhe të natyrës mbase edhe parimore, janë bartë në terrenin e botës intelektuale shqiptare në IRJM dhe tani ato atje kanë një jetë të pavaruar, sikurse do probleme që kanë rrënjët dikund, por mëpastaj ato fillojnë me një dinamikë tjetër të lëvizin. Dhe unë e them se dinamika i dedikohet shoqërisë shqiptare në IRJM, por, e them prap se, rrënjët e përqarjeve atje vazhdojnë t'i kenë nga Kosova. Edhe pse Kosova ka luajtur atë rol që ka luajtur Shqipëria ndaj Kosovës edhe në segmentet e tjera politike. Problemet dhe çështja e statusit të pozitës së shqiptarëve atje dhe kërkesave të tyre politike në shumicën e rasteve kanë pasur origjinën nga Kosova.

**Fakti: Këto që i thoni ju, janë pasojë e ndikimit të individëve të ndryshëm apo kjo është bërë në mënyrë sistematike?**

**Enver Hasani:** Mendoj se është çështje e individëve, pra e përsëris se është çështje e individëve dhe kalkulimeve të ndryshme të niveleve të ndryshme nga Kosova, të cilët janë bartur atje dhe shumë herë kanë acaruar dhe kanë vështësuar pozitën e UT-së në sytë e botës së qytetëruar dhe në sytë e vetë sllavomaqedonasve.

**Fakti: Cila duhet të jetë strategjia e faktorit shqiptar në IRJM, me të cilën ata duhet të ndërtojnë të ardhmën e vet prosperuese?**

**Enver Hasani:** Shqiptarët e IRJM-së do të

*Box/ Shqiptarët e IRJM-së do të duhet më tepër të analizojnë raportin e forcave dhe të jenë të vetëdijshëm se ndarja apo prishja e Maqedonisë, më së paku do t'i konvenonte faktorit shqiptar dhe kjo është një matematikë fare e thjeshtë. Në rast se do të ketë tronditje esenciale të IRJM-së, shqiptarët do të dilnin humbësit më të mdhenjë. E dyta, zbatimi i Marrëveshjes së Ohrit mendoj se është prespektiva e vetme, për të cilën dhe rreth së cilës, duhet për momentin t'i bashkojnë forcat spektri politik shqiptar dhe nëse bëhet kjo, unë besoj se edhe ndikimi nga jashtë do të jetë shumë më i vogël.*

duhet më tepër të analizojnë raportin e forcave dhe të jenë të vetëdijshëm se ndarja apo prishja e Maqedonisë, më së paku do t'i konvenonte faktorit shqiptar dhe kjo është një matematikë fare e thjeshtë. Në rast se do të ketë tronditje esenciale të IRJM-së, shqiptarët do të dilnin humbësit më të mdhenjë. E dyta, zbatimi i Marrëveshjes së Ohrit mendoj se është prespektiva e vetme, për të cilën dhe rreth së cilës, duhet për momentin t'i bashkojnë forcat spektri politik shqiptar dhe nëse bëhet kjo, unë besoj se edhe ndikimi nga jashtë do të jetë shumë më i vogël.